



RREGULLORE NR. 2005/22

**PËR SHPALLJEN E LIGJIT MBI TREGTINË E NAFTËS DHE PRODUKTEVE
TË SAJ TË MIRATUAR NGA KUVENDI I KOSOVËS**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (RKSKB) të datës 10 qershor 1999,

Në pajtim me kapitullin 8 dhe nenet 9.1.44 dhe 9.1.45 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001),

Duke marrë parasysh shkresën zyrtare nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës të datës 29 mars 2004 lidhur me Ligjin mbi tregtinë e naftës dhe produkteve të saj të miratuar nga Kuvendi më 17 mars 2004, si dhe shkresën e datës 28 prill 2005 me të cilën konfirmon miratimin nga Kuvendi i Kosovës më 22 prill 2005 me ndryshimet dhe përmirësimet e nevojshme,

Duke konstatuar se dispozitat e Ligjit nuk e cenojnë pushtetin e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm sipas RKSKB 1244 (1999) apo pushtetin e tij të rezervuar dhe përgjegjësitë sipas Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, veçanërisht nenin 8.1 (q) të saj dhe 8.1 (r) të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë,

Duke vënë re me kohë dhe pa cenuar Rregulloren e ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2001/12 të datës 13 qershor 2002 mbi themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit,

Me anë të kësaj shpall Ligjin mbi naftën dhe produkteve të saj, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës (Ligji nr. 2004/5), që i bashkëngjitet kësaj Rregulloreje, i cili bëhet i plotfuqishëm në ditën e nënshkrimit.

Nënshkruar sot, më 7 maj 2005.

Søren Jessen-Petersen
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm